



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1770/4 Prot.

Tiranë, më 14.07.2025

VENDIM

Nr. 39 Datë 14.07 2025

“PËR
DY NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE E ANALITIKE TË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS”

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", nenit 49, në Statutin e UST-së neni 43, gërma II), në VKM me nr. 243, datë 20.04.2023 "Për një ndryshim në VKM nr.748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë", të ndryshuar, në Udhëzimin e MASR nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", në Vendimin e Senatit nr.13, datë 28.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative, analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2025, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.08, datë 29.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike, dhe klasifikimit të pagës për vitin 2025 në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 1053/1 prot., datë 24.06.2025 "Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për titullin akademik "Profesor i Asociuar", si dhe në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me nr. 1054/1 prot., datë 24.06.2025 "Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për titullin akademik "Profesor", si dhe në Vendimin e Rektoratit me nr. 78, datë 09.07.2025 "Për dy ndryshime në strukturën organizative e analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës", në Vendimin e Senatit Akademik nr 80 datë 14.07.2025, Bordi I Administrimit në mbledhjen e datës 17.07.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin dhe ndryshimin e strukturës organizative dhe analitike të Universitetit të Sporteve të Tiranës, si më poshtë
 - **Z. Ferdinand Aqif Mara**, Drejtues i Departamentit të Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, me titullin akademik "Profesor i Asociuar" kalon me titullin akademik "Profesor" nga data 24.06.2025 e në vazhdim.
 - **Z. Elton Vasil Bano**, Personel Akademik pranë Departamentit të Sporteve Individuale në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, me gradën shkencore

"Doktor" kalon me titullin akademik "Profesor i Asociuar" nga data 24.06.2025 e në vazhdim.

2. Efektet financiare shtrihen nga data e përfitimit të titullit akademik dhe në zbatim të VKM me nr.243, datë 20.04.2023, "Për një ndryshim në vendimin nr.748, datë 11.06.2009, të Këshillit të Ministrave, për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, Lidhja nr.1.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori, Njësitë kryesore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI

